

SHP TETOVË

PENSIONISTËT NË TRIBUNËN KUSHTUAR EKOLOGJISË

Pensionistët pjesëmarrës në këtë tribunë shprehën gatishmërinë e tyre që të jenë krah komunës dhe institucioneve të tjera, për të ndihmuar në mirëmbajtjen e ambientit ekologjik në qytet, kjo sidomos pas shpalljes së këtij viti nga ana LSHPM si vit i ekologjisë

Në organizim të organizatës joqeveritare "Multikultura" dhe me mbështetje të Fondacionit Shoqëria e Hapur, ditë më parë, në ambientet e komunës së Tetovës u mbajt tryeza kushtuar çështjeve të ambientit dhe ekologjisë. Në këtë tryezë të pranishëm ishin edhe krerët e Shoqatës së pensionistëve të Tetovës, të cilët në mënyrë aktive kontribuan në ndriçimin e segmenteve të ndryshëm që kanë të bëjnë me ambientin jetësor.

Kryetari i Komunës së Tetovës, Bilall Kasami në paraqitjen e tij para të pranishmëve, ndër të tjera nënvizoi se ruajtja e ambientit jetësor është njëra nga çështjet prioritare të komunës. Me këtë problematikë strukturat komunale dhe ndërmarrja kompetente e mirëmbajtjes së ambientit jetësor, janë të angazhuara 24 orë në mënyrë mbetjet të pastrohen në kohë dhe në mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike në qytet. Megjithatë, sipas Kasamit, përkundër angazhimit maksimal të komunës, prapëseprapë në pjesë të ndryshme të qytetit hasim në grumbuj mbetjesh,



madje material të ndryshme, si mobile, aparate amvisërie, materiale të ngurta, që vështirë se mund të menaxhohen. "Fatkeqësisht një pjesë e qytetarëve nuk janë të ndërgjegjshëm për ambientin ekologjik. Qyteti i Tetovës ka rreth 85.000 banorë, kurse brenda ditës nëpër rrugët e qytetit qarkullojnë edhe një 50 mijë banorë të tjerë të komunave përreth. E gjithë kjo nënkupton se bëhet fjalë për një mjedis që kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme, jo vetëm nga institucionet përkatëse por edhe nga vetë qytetarët", theksoi Kasami.

Kryetari i Shoqatës së pensionistëve të Tetovës, Selver Memeti, në fjalën e tij para të pranishmëve, edhe njëherë aktualizoi çështjen e qenve endacakë që po qarkullojnë nëpër rrugët e qytetit. Ai tha se kjo çështje nuk po zgjidhet, duke kërkuar një angazhim konkret nga komuna marrjen e masave, sepse përveç ndotjeve të shumta, qentë janë të rrezikshëm edhe për popullatën. Kryetari i Tetovës, Bilall Kasami, duke iu përgjigjur

kësaj dileme tha se çështja e qenve endacakë nuk mund të zgjidhet në nivelin lokal por në rrafshin nacional. "Ajo që mund të bëjmë ne është izolimi i qenve të rrezikshëm, trajtimi i tyre dhe kthimi në vendin e ndodhjes. Vetëm me angazhimin e institucioneve qendrore shtetërore mund të zgjidhet problemi me qentë endacak", nënvizoi Kasami.

Pensionistët pjesëmarrës në këtë tribunë shprehën gatishmërinë e tyre që të jenë krah komunës dhe institucioneve të tjera, për të ndihmuar në mirëmbajtjen e ambientit ekologjik në qytet, kjo sidomos pas shpalljes së këtij viti nga ana LSHPM si vit i ekologjisë. Pensionistët janë shtresa e popullatës që më së shumti është e interesuar për një ambient të pastër jetësor e të punës. Në këtë drejtim asnjëherë nuk do të pushojnë aktivitetet e organizimit pensional, përfshirë edhe kujdesin permanent ndaj rruahtjes së ambientit jetësor, vlerësuat në këtë takim pensionistët pjesëmarrës. (M. Murseli)



Mbështetje humanitare për viktimat

Komisioni i Aktivitet Grave të Shoqatës së Pensionistëve të Koçanit, organizoi një aktivitet humanitar për të ndihmuar familjet e viktimave dhe të lënduarve në zjarrin në diskotekë "Puls" që ndodhi më 16 mars të këtij viti. Përveç pensionistëve të Koçanit, në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues të shoqatave nga Komuna Qendër, Gazi Babë dhe Vinicë dhe e Shkupit. Me emocione të hapura dhe me shpresën se Koçani do të shërohet nga ngjarja tragjike, ato shprehën unitet në momentet më të vështira, që është mënyra më e mirë për të shëruar plagët. "Jam shumë krenare, por edhe e trazuar për pjesëmarrjen masive të bashkëqytetarëve tanë të moshës së tretë, qytetarëve të Koçanit dhe më gjerë. Jam veçanërisht mirënjohëse për pensionistët nga shoqatat nga Qendra, Gazi Babë e Shkup dhe ShP e Vinicës, të cilët iu bashkuan këtij aktiviteti humanitar. Jam krenare, sepse po tregojmë humanizëm në veprim, dhe e shqetësuar për shkak të traumave që la pas ngjarja tragjike, nga e cila ende nuk mund të shërohemi. Është mirë që gjithçka që u prodhuan u shit dhe fondet e mbledhura do të përfundojnë tek ata që kanë më shumë nevojë", tha kryetarja e SHP të Koçanit, Jelica Zafirova.

"Është e vështirë të jesh pjesë e një ngjarjeje kaq humanitare, kur e dimë se çfarë dëmsh kanë mbetur pas zjarrit në diskoteken Puls, por ne, si fqinjët e parë, jemi këtu për të dhënë një kontribut të vogël, por domethënës për të ngushëlluar familjet e viktimave. Po marrim pjesë me specialitetet tona shtëpiake, por edhe me një donacion modest", u shpreh Pavlina Angelovska nga Fondacioni i Komunitetit të Vinicës. "Nuk hezitua aspak të vinim dhe të bëhemi pjesë e ngjarjes humanitare, sepse ndiejmë se mbështetja e qytetarëve të Koçanit është e nevojshme më shumë se kurrë. Këto muajt e fundit e kemi përjetuar tragjedinë me dhimbje të madhe, por lutemi gjithashtu që të gjithë të gjejnë forcë dhe të kontribuojnë në rimëkëmbjen e Koçanit dhe të Maqedonisë", thotë Branka Stojanovska nga SHP Qendër. (L. Dimitrov)



Jakup Islami është një prej figurave më të respektuara të komunitetit tonë, i cili ka lënë gjurmë të pashlyeshme gjatë gjithë jetës së tij profesionale dhe shoqërore. Me një karrierë të gjatë e të ndritur në fushën e arsimit (43) vjeçare, ai ka shërbyer me përkushtim, ndershmëri dhe përlësi ndaj detyrës dhe njerëzve që e rrethonin. I lindur në vitin 1947 në fshatin Gajre të Tetovës dhe pas një shkollimi adekuat të asaj kohe përfundon kualifikimin për mësuesi, profesion të cilin e ka ushtruar gjatë tërë jetës së tij. Fillimisht punësohet në Zhelinë, në mënyrë që pastaj të vazhdojë karrierën e tij si mësues në fsha-

PORTRET I NJË PENSIONISTI TË DALLUAR

Jakup Islami, shembull për të gjithë të tjerët

Ndonëse pensionist, i cili mban mbi supë një moshë bukur të theksuar, duke gëzuar shëndet të plotë, Jakup Islami në tokën e tij në fshatin e lindjes, ka sistemuar një sasi të konsiderueshme të koshereve me bletë, të cilat i kultivon me ëndje dhe përkushtim

tin Çellopek, ku kontribuojë në edukimin dhe arsimimin e shumë gjeneratave të reja deri në pensionim.

Gjatë viteve të punës Islami u dallua me profesionalizmin dhe humanizmin e tij, duke qenë gjithmonë e gatshëm të jep gjithçka nga vetja, vetëm e vetëm për një edukim e arsimim sa më cilësor të shumë brezave të rinj, të cilët i udhëzoi drejtë rrugës që duhet të hapërojnë në jetën e tyre, dhe po kështu duke ndihmuar kolegët dhe komunitetin në përgjithësi. Ai ka qenë gjithashtu një model i vërtetë për brezat e rinj, duke frymëzuar me shembullin e tij dhe duke dhënë kontribut në edukimin dhe formimin e personalitetit të tyre.

Edhe pas daljes së pension, ai vazhdon të jetë aktiv në jetën shoqërore e kulturore, në veprimtarinë me të cilën prej kohësh është

mishëruar, bletarinë dhe gjithashtu është i dalluar me aktivitetet e tij në forma të ndryshme të organizimit pensional. Për të gjitha këto Islami vlerësohet nga rrethi ku jeton dhe vepron, sidomos nga shoqata e pensionistëve të Tetovës në përgjithësi, si pensionist i dalluar, si shembull i një jete të ndërtuar me dinjitet, punë të ndershme dhe dashuri ndaj njerëzve. Ndonëse pensionist, i cili mban mbi supë një moshë bukur të theksuar, duke gëzuar shëndet të plotë, Jakup Islami në tokën e tij në fshatin e lindjes, ka sistemuar një sasi të konsiderueshme të koshereve me bletë, të cilat i kultivon me ëndje dhe përkushtim. Për "ushtrinë" e tij të bletëve Islami kujdeset në vazhdimësi, duke e përcjellë çdo lëvizje e qarkullim të bletëve, me të cilat bashkëjeton me një ndjesi të veçantë. Kjo veprimtari jo se i sjell të ardhur-

ra të dukshme, por më tepër e ushtron si hobi, duke i kaluar ditët në shoqërim të bletëve. Jakup Islami shquhet edhe për mikpritjen që u bënë të afërmve, farefisit, miqve e pensionistëve, të cilët shpeshherë e vizitojnë tek vendi i angazhimit të tij në Gajre. Të gjithë ata, pos me gjëra të tjera shërbehen me mjaltin e pastër natyror të cilin e kultivon tash e 20 vite. Siç thotë vetë Islami, në qoftë se nuk ka për treg, për miq e dasha mirë gjithmonë ka mjaltë me bollëk. Islami me familjen e tij jeton në qytetin e Tetovës, ndërsa ka krijuar një familje të shëndosh me pasardhës të shkolluar në profile të ndryshme. Duke i dëshiruar shëndet e mirëqenie këtij pensionisti të dalluar me aktivitetin e tij të gjithanshëm, u larguam nga Gajrja piktoreske, për t'u takuar sërish për raste të tjera në periudhën e ardhshme. (M. Murseli)